

Thirrje për aplikantë

Bashkohu me Programin tonë të Mentorimit për Reduktimin dhe Riciklimin e Plastikës

- ✓ A jeni një kompani e vogël ose e mesme me bazë në Shqipëri ose Kosovë?
- ✓ A përdorni një sasi të konsiderueshme të plastikës në biznesin tuaj apo merreni me riciklim?
- ✓ A keni menduar të reduktoni ose ricikloni plastikën por nuk dini nga t'ia filloni?

Nëse po, atëhere kjo thirrje është për ty.

Aplikoni tani në programin tonë të mentorimit të krijuar posaçërisht për sipërmarrje të regjistruara në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, dhe Mal të Zi.

Si pjesë e programit, ju do të keni mundësinë të shfaqni ide konkrete projekti, ambicie, inovacion, për të zhvilluar ose përmirësuar proceset tuaja të reduktimit dhe/ose riciklimit të plastikës, si dhe për të përshtatur produktet dhe shërbimet tuaja. Skuadra jonë e përbërë nga ekspertë ndërkombëtarë, do të vlerësojë aplikimet dhe përzgjedhë fituesit. Nëse përzgjidheni, ekspertët tanë ndërkombëtarë do t'ju ofrojnë këshilla teknike, dhe mentorim përgjatë 3 vizitave në kompaninë tuaj, në mënyrë që t'ju udhëheqin drejt transformimit duke ndërmarrë hapa strategjik.

Ky program paraqet një mundësi unike për NVM-të (ndermarrje të vogla e të mesme) për të mësuar se si të zhvillojnë dhe përmirësojnë proceset e tyre të riciklimit/reduktimit të plastikës dhe të përshtasin produktet ose shërbimet e tyre.

Pas përfundimit të programit, dhe zbatimit me sukses të planit të veprimit, pjesëmarrësit do të pajisen me një certifikatë për arritje nga skuadra e GIZ dhe ajo e ekspertëve ndërkombëtarë.


PËRFITIMET NGA PROGRAMI:

- ✓ Deri në tre vizita këshillimi teknik nga ekspertët ndërkombëtarë për çështje si reduktimi i paketimeve plastike, përmirësimi i proçeseve të riciklimit, zhvillimi i biznesit, marketingu, shitjet, dhe të tjera.
- ✓ Mundësi për shkëmbim B2B në Mars 2024 në Shqipëri për aplikantët e përzgjedhur nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova ose Mali i Zi.
- ✓ Një vizitë studimore plotësisht e financuar në Vjenë, Austri, në Pranverë 2024 për 3 kompanitë me performancë më të mirë për çdo vend.

Në fund të programit, pjesmarrësve do t'ju jepet çertifikata. Të gjitha kostot për përfitimet e përmendura me lart do të mbulohen nga GIZ.

KRITERET E PRANIMIT:

- Të jeni një ndërmarrje/kompani e vogël ose e mesme me një ide apo projekt konkret për reduktimin dhe riciklimin e plastikës.
- Biznesi juaj të jetë i regjistruar prej të paktën 2 vitesh në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë ose Mali i Zi.
- Të keni identifikuar një produkt, shërbim ose projekt lidhur me reduktimin ose riciklimin e plastikës i cili mund të zhvillohet ose zgjerohet.
- Biznesi juaj të ketë të paktën 2 punonjës në një nga vendet e përmendura më sipër.
- Biznesi juaj të ketë një adresë fizike dhe aktivitet (si p.sh shitjet, marketing, kërkim dhe zhvillim, apo administrim) në një nga vendet e lartpërmendura.
- Biznesi juaj duhet të veprojë në pajtueshmëri me ligjet kombëtare të punës, dhe pa asnjë ndikim negativ në shëndetin e njerëzve, shëndetin e kafshëve dhe mjedisin.
- NVM me pronarë apo bashkëpronarë gra/vajza janë të inkurajuar në mënyrë të veçantë të aplikojnë.



Aplikoni sot dhe kontribuoni me një ndikim pozitiv në reduktimin dhe riciklimin e plastikës në biznesin tuaj!

Ju lutem kini parasysh që ky program nuk ofron financim për mbulimin e kostove që mund të krijohen për shkak të këshillimit teknik ose zhvillimit të produktit.

Nëse keni pyetje, nëse dëshironi të merrni një kopje të aplikimit në gjuhën shqipe apo linqet e sesioneve online, ju lutem na shkruani këtu tek reduce.recycle@giz.de dhe ne do t'ju përgjigjemi.

Ose nëse e dëshironi të aplikoni, ju lutem klikoni 📧 <https://rb.gy/2f2z3> dhe plotësoni formularin e aplikimit.

Kjo thirrje për pjesmarrës është mbështetur nga GIZ në emër të Qeverisë Gjermane përmes programit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Parandalimit të Mbetjeve Detare në Ballkanin Perëndimor. Ky program ka katër vende partnere, Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën, dhe Malin e Zi.

Më shumë informacion lidhur me programin mund të gjeni tek faqja e web: [Preventing marine litter in the Western Balkans \(giz.de\)](https://www.giz.de/press/press-releases/2021/01/20210121-preventing-marine-litter-in-the-western-balkans)